



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS

RAPORTI VJETOR 2003

Prishtinë, 2004

PËRMBAJTJA

FJALA E RASTIT E KRYETARES SË BORDIT	3
BORDI I DREJTOREVE TE RTK-SE	3
FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM.....	4
HYRJE	6
SYNIMET PËR VITIN 2003.....	6
PARAPAGIMI	7
TELEVIZIONI	9
LAJMET	11
PROGRAMI INFORMATIV	11
KOMUNITETET ETNIKE.....	13
PROGRAMI I MËNGJESIT.....	14
PROGRAMI KULTUROR-ARSIMOR.....	14
PROGRAMI ARGËTUES DHE MUZIKOR	15
PROGRAMI I VITIT TË RI.....	16
SHIKUESHMËRIA	16
SHPËRBLIMET	19
WWW.RTKLIVE.COM	19
OPERACIONET DHE TEKNIKA.....	20
REKAPITULIM I VEPRIMTARISË OPERATIVO-TEKNIKE	21
PROGRAMET INFORMATIVE	22
NJËSIA E SUBTITLIMIT	23
RADIO	24
EMISIONET INFORMATIVE DHE LAJMET	24
PIKAT UNIKE PROGRAMORE	25
KOMUNITETET ETNIKE.....	25
SHPËRBLIMET	26
FAQJA E INERNETIT NË BLUE SKY E RADIO KOSOVË.....	26
BESUESHMËRIA DHE DËGJUESHMËRIA.....	26
SHËRBIMET E PËRBASHKËTA TË RTK-SË.....	28
ADMINISTRATA	28
PROKURIMI	29
FINANCAT	30
DONATORËT	30
BILANCI I GJENDJES DHE I SUKSESIT PËR VITIN 2003.....	31

FJALA E RASTIT E KRYETARES SË BORDIT

BORDI I DREJTOREVE TE RTK-SE

RTK-ja përbëhet prej dy organeve: Bordit të Drejtorëve dhe prej Operativës Transmetuese.

Bordi i RTK-së përbëhet prej nëntë anëtarëve, prej të cilëve tre janë ndërkombëtar dhe gjashtë janë vendorë, banorë të Kosovës... të cilët pasqyrojnë shtresë të gjerë të shoqërisë civile dhe multietnike.

Anëtarët e Bordit të RTK-së i emëron Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, me rekomandim të Zëvendëspërfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Ndërtimin e Institucioneve. (Rregullorja Nr.2001/13, UNMIK/Reg/2001/13)

Të nderuar,

Me këtë raport publik, ne plotesojmë edhe një obligim për informim sa me të mirë të qytetarëve të Kosovës. Viti 2003 ishte i mbushur me zhvillime pozitive dhe me sfida të ndryshme për realizimin e mandatit si është i përshkruar me Rregulloren mbi Themelimin e RTK-së si institucion jofitimprurës i shërbimeve të transmetimeve publike.

Të jemi të pavarur dhe të paaneshëm, duke pasqyruar integritet, maturi në pasqyrimin e çështjeve aktuale, të përkrahim zhvillimin kulturor dhe shumëllojshmërinë kulturore të Kosovës, t'u ofrojmë të gjitha komuniteteve etnike mundësinë e shprehjes në gjuhën e tyre; janë principet bazë mbi të cilat RTK i ka zhvilluar politikat edhe gjatë vitit të kaluar.

RTK e shef rolin edhe në krijimin e hapësirës për dialog në mes qytetarëve të Kosovës, edhe të tyre me botën. Në këtë drejtim ka edhe mjaft hapësirë për zhvillim.

Me vizion të tillë, ne shpresojmë të punojmë me ndihmën e qytetarëve, të zhvillojme RTK-në si institucion të mirefilltë publik për të gjithë Kosovarët.

Vjosa Dobruna,

Kryetare e Bordit të RTK-së

FJALA E HYRJES E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë këtij viti ishim dëshmitarë të sendërtimit të sentencës se shërbimi i mirëfilltë publik ka për aleat të qëndrueshëm vetëm audiencën. Jetësimi i kontratës për parapagim dhe reforma programore në televizion dhe radio shprehin qartazi besimin tonë në këtë porosi.

Gjithmonë kemi dëshiruar që të jemi të varur vetëm nga qytetarët e Kosovës dhe që në rend të parë t'u japim atyre llogari. Njëherit jemi të angazhuar t'i përmbushim kërkesat dhe nevojat e të gjitha segmenteve të popullsisë. Me këtë pikësynim, Radio Televizioni i Kosovës, i përqëndruar me energji dhe profesionalizëm, ka negociuar në pjesën më të madhe të vitit 2003 për arritjen e kontratës së shërbimit për parapagimin me Korporatën Energjetike të Kosovës. Dëshiroj të falenderoj menaxhmentin e kësaj korporate, Komisionerin e Përkohshëm për Media, OSBE-në, UNMIK-un, si dhe institucionet vendore të Kosovës për përkrahjen në realizimin e marrëveshjes midis RTK-së dhe KEK-ut. Veçanërisht dëshiroj të falenderoj USAID-in që investoi mjete të konsiderueshme për sajimin e softuare-it, i cili është bazë edhe për RTK-në, si dhe për përkrahjen dhe inkurajimin e procesit të negociimit në mes të RTK-së dhe KEK-ut.

Fakti që përkundër vështirësive të mëdha sociale dhe ngarkesave të shumta dhe të rënda, nga të cilat ende vuan sektori elektro-energjetik, marrëveshja për parapagim u nënshkrua dhe filloi të implementohet në vitin e dytë të drejtimit të RTK-së nga manaxhmenti kosovar, gjithësesi meriton përkrahje dhe mbështetje nga komuniteti donator, që e vlerëson rolin dhe rëndësinë e shërbimit të mirë transmetues për Kosovën në të tashmen dhe në të ardhmen. Pikërisht këtë e tregon përkrahja e vazhduar e qeverisë zvicerane për modernizimin e radiove dhe këtë vit edhe për pasurimin programor në televizion. Në sajë të kësaj përkrahje, në shtator 2003, RTK-ja filloi transmetimin e programit në gjuhën e pestë, atë rome. Me këtë program, RTK-ja e plotëson reliefin shumë-etnik dhe shumë-gjuhësor të shoqërisë kosovare, si shprehje adekuate e misionit tonë integruar, që promovon vlerat demokratike.

Në aspektin programor, RTK-ja ndonëse e vetëdijshme për mundësinë ose rrezikun e 'humbjes' së përkohshme të një pjese të audiencës, është përmbajtur nga emetimi i programeve dhe serialeve me vlera të dyshimta. RTK-ja ka ofruar programe cilësore përkundër rrezikut të 'oshilimit' të shikueshmërisë, sepse beson se në shtigje të gjata shërbimi publik i transmetimit i shërben kultivimit të shijeve cilësore të qytetarëve. Për këtë u krye reforma e suksesshme e skemës programore të radios dhe përgatitjet intensive për kalim në emetim 24-orësh të programit televiziv. Edhe ky vit ka qenë vit i sprovave në kërkimin e modelit më të përshtatshëm të legjisllacionit medial, që për RTK-në do të thotë angazhim shpeshherë jo i lehtë për të ecur në traditat më të mira të transmetuesve publik evropian.

RTK-ja ka hyrë tashmë në një fazë të re emancipimi, si shërbim publik që angazhohet të finanohet kryesisht nga qytetarët, gjë që më së miri i vetëdijëson vetë qytetarët për thelbin dhe tiparet dalluese të shërbimit publik të transmetimit.

Jam i sigurt se me përkrahjen e të gjithëve RTK-ja do vazhdoj të jetë për të gjithë qytetarët një shërbim i mirëfilltë, profesional dhe i pavarur transmetues i Kosovës dhe për Kosovën.

Agim Zatriqi

HYRJE

Viti 2003 ka qenë vit i sfidave dhe i të arriturave të mëtejme zhvillimore të RTK-së, si transmetues i vetëm publik në Kosovë. Duke ngritur prestigjin, besueshmërinë, shikueshmërinë e Televizionit dhe dëgjueshmërinë e Radiove, RTK-ja ka arritur gjatë vitit 2003 të bëjë depërtime të rëndësishme në mesin e audiencës në Kosovë dhe jasht saj. Gjithnjë duke i qëndruar besnik misionit të vet të një transmetuesi dhe shërbimi të pavarur publik, RTK-ja ka ofruar program për të gjithë, përfshirë edhe komunitetet etnike dhe shtresa të ndryshme të shoqërisë kosovare.

Radiotelevizioni i Kosovës edhe gjatë vitit 2003 ka rikonfirmuar rolin e vet të pazëvendësueshëm të transmetuesit të pavarur publik të Kosovës dhe ka ridëshmuar rolin e vet kyç në informimin e opinionit kosovar. Ai ka aritur të zë vendin e vet si transmetues i riformuar, me influencë dhe i respektuar publik në Kosovë dhe në rajon.

SYNIMET PËR VITIN 2003

Synimet kryesore të RTK-së për vitin 2003 janë plotësuar pothuajse tërësisht:

- ruajtja e pavarësisë editoriale të RTK-së dhe nxitja e politikës së balancuar dhe të paanshme redaktuese;
- përqëndrimi në zhvillimin e programit të cilësisë së lartë, me përmbajtje informative, arsimore dhe argëtuese;
- përgaditjet për kalim në skemën programore 24-orëshe në Televizion;
- sforcimi i identitetit të RTK-së si transmetues publik përmes llojllojshmërisë dhe cilësisë programore;
- fillimi i edicionit të lajmeve "Info" në orët e pasditës, për të plotësuar buletinet e zgjeruara në orën 19:30 dhe 23:00;
- zgjatja dhe përforcimi i transmetimit për komunitete, me fillimin e një emisioni javor edhe në gjuhën e pestë – atë rome në Televizion dhe me inicimin e programit në gjuhën boshnjake në Radio;
- pranimi i gazetarëve plotësues për çdo redaksi të lajmeve në gjuhët përkatëse dhe gjetja e mundësive për këmbim të programeve me stacione të tjera televizive që kanë synime dhe koncept të ngjashëm me RTK-në;
- përqëndrimi i trajnimit mbi vlerat e gazetarisë dhe të redaktimit, administrimit të programeve me bazë në studio, dhe trajnimin mbi menaxhimin e nivelit të mesëm;
- zhvillimi i njësisë për sport, planifikimi për programin sportiv të pasditës gjatë fundjavës, etj.
- zhvillimi dhe përforcimi i redaksisë së muzikës.
- zhvillimi dhe përforcimi i redaksisë së web-faqes.

Radio Televizioni i Kosovës, filloi me punë në vitin 1999 si operacion emergjent transmetues në bazë të një Memorandumi për Mirëkuptim ndërmjet OSCE-së dhe Unioni Evropian i Transmetimeve (EBU-së). Në vitin 2001 RTK-ja në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2001/13 themelohet si shërbim publik transmetues i Kosovës. RTK-ja përbëhet nga Televizioni i Kosovës që transmeton dy programe, atë terrestrial dhe satelitor, dhe nga dy radio, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky. Televizioni dhe dy radiot suplementohen edhe nga distribuimi i informatave në web faqet e tyre.

PARAPAGIMI

Radio Televizioni i Kosovës është shërbimi më i ri publik i transmetimit në Evropë. Në saje të përkrahjes së bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve të Kosovës, kosovarët kanë radio televizionin e tyre publik të pavarur.

Si shërbim publik transmetues, RTK-ja është pjesë e demokratizimit dhe një nga institucionet më të rëndësishme të Kosovës. Si e tillë, RTK-ja i ndihmon shprehjes së pluralizmit politik, diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor, fetar si dhe kultivimit të mëtejme të produktionit vendor dhe në tërësi integritit social.

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/13 si Transmetues Publik në Kosovë.

Përmes këtij akti juridik RTK-ja në cilësinë e personit juridik, përveç tjerave, ka të rregulluar edhe çështjen e financimit. Kapitulli IV përcakton Burimet e financimit të RTK-së, në të cilën përveç burimeve plotësuese, në Nenin 11.2 është përcaktuar edhe financimi i tij përmes parapagimit, ku ceket:

“11.2 RTK-ja financohet nga të ardhurat që krijohen nga parapagimi. Detajet e parapagimit për programeve transmetimit publik, duke përfshirë përvetësimin e të ardhurave të krijuara nga parapagimi, do të caktohen në një urdhëresë administrative e cila do të nxirret nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.”

Nisur nga kjo, më 3 qershor 2003, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nënshkroi Urdhëresën Administrative 2003/12 me kërkesë që “çdo shtëpi, biznes, ndërmarrje apo institucion tjetër” të bëjë parapagimin mujor prej 3.5 Euro për sigurimin e finansimit të pavarur për televizionin dhe radion publike në Kosovë – do të thotë për Radio Televizionin e Kosovës.

Kjo kërkesë ligjore është në linjë me mënyrat e përgjithshme evropiane të financimit të transmetuesit publik, që i ofron qytetarëve të Kosovës një shërbim të rëndësishëm të lajmeve dhe të programit kulturor dhe argëtues.

Grupet punuese të RTK-së dhe KEK-ut kanë arritur marrëveshjen pas negociatave shumëmuajshe, për zbatimin e Urdhëresës Administrative me qëllim që parapagimi për RTK-në të zbatohet përmes faturave të Koorporatës Energjetike të Kosovës. Agjensia për Ndihmë Ndërkombëtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) ka ndihmuar përmes softuerit me anë të cilit do të bëhet llogaritja e parapagimit edhe të RTK-së në faturat e KEK-ut. Ndërkaq gjatë tërë periudhës së negociatave, RTK-ja dhe KEK-u janë ndihmuar nga ana e Zyrës së Komisionerit të Përkohshëm për Media dhe përfaqësuesve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Pas negociatave shumëmuajshe, më 18 nëntor 2003, është nënshkruar kontrata RTK-KEK, sipas së cilës KEK-u do të mbledhë këtë parapagim si shërbim për RTK-në duke filluar nga faturat e muajit nëntor 2003.

Duke u bazuar në Urdhëresën Administrative 2003/12, nga pagesa e parapagimit përjashtohen vetëm familjet e përfshira në listën e skemës së asistencës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Meqenëse, RTK si dhe dy rrjetet komerciale, KTV dhe RTV 21, servisohen nga Rrjeti Kosovar i Transmetuesit Televiziv (KTTN), një organizatë deri tash e financuar ndërkombëtarisht, për distribuimin e sinjalit të programit të tyre, është duke u punuar në mbulimin e tërë vendbanimeve të pambuluarra të Kosovës me sinjal tokësor televiziv. Programet e radios së RTK-së tashmë mbulojnë tërë Kosovën.

Parapagimi mundëson plotësimin e detyrave të shumta që i parashtrohen shërbimit publik, vendos lidhjen e drejpërdrejtë midis transmetuesit dhe qytetarëve dhe lejon që shërbimi publik t’u përgjigjet drejtpërdrejt qytetarëve për punën e vet. Përmes parapagimit, qytetarët do të kenë mundësi të përcjelljes së programeve të transmetuesit publik me standarte të larta, programe të paanshme informative, programe të avancuara arsimore, programe gjithëpërfshirëse kulturore si dhe programe atraktive argëtuese.

Njëkohësisht, përkrahja e qytetarëve të Kosovës përmes parapagimit do t'i ndihmonte RTK-së si shërbim publik i transmetimit, që në të ardhmen të mos e ngarkojë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Radio Televizioni Publik, si institucion jofitim-prurës, investon këto të ardhura në përmirësimin e zgjerimin programor dhe ngritjen e cilësisë operative-teknike të transmetimit. Të gjitha të ardhurat nga parapagimi do të shfrytëzohen në mënyrën që garanton vazhdimin e funksionimit stabil dhe planifikimin afatgjatë të zhvillimit të transmetuesit publik.

Financimi i RTK-së përmes parapagimit është vendimtar për punën e tij të mëtutjeshme si një shërbim publik i transmetimit i qendrueshëm dhe i pranueshëm për të gjithë. Kjo aspak nuk e përjashton apo zvogëlon nevojën dhe të drejtën e RTK-së për të patur qasje edhe ndaj burimeve tjera, në pajtim me modelin e kombinuar të financimit i cili mbështetet në traditat më të mira evropiane.

TELEVIZIONI

Televizioni i Kosovës gjatë vitit 2003 ka arritur një shkallë të lartë të përmbushjes së objektivave të tij dhe obligimeve të një transmetuesi respektabil publik.

Argument i pakontestueshëm për këto të arritura është fakti se edhe në vitin 2003 Televizioni i Kosovës, sipas të gjitha hulumtimeve të pavarura të opinionit, ka ruajtur dhe përforcuar vendin e prijësit medial në Kosovë.

Në kuadër të programit informativ, gjithësesi duhet të veçohet fushata mediale e RTK-së e titulluar "RES PUBLICA". Kjo fushatë në radhë të parë kishte për qëllim informimin dhe vetëdijsimin e audiencës për rëndësinë e ruajtjes dhe kultivimit të shërbimit publik transmetues dhe pavarësisë editoriale të këtij shërbimi, pra RTK-së. Kjo fushatë e gjerë në Radio Televizionin e Kosovës është manifestuar në formë të debateve jashtëzakonisht interesante. Këto debate si dhe të gjitha spotet promovuese kanë pasur për qëllim promovimin e konceptit të një shërbimi publik dhe dallimet esenciale të Radio Televizionit publik nga ai shtetëror, dhe në masë të konsiderueshme ky qëllim është arritur.

Efektet e këtij debati kanë qenë mjaft të mëdha. Argument për këtë janë rezultatet e hulumtimit të qendrës për studime humanistike "Gani Bobi", nga ku del se mbi 50% të të anketuarve e dijnë se RTK-ja është medium publik.

Startimi i suksesshëm i Programit Arsimor, i edicionit të ri të lajmeve (INFO), pastaj rritja e numrit të emisioneve dokumentare dhe për fëmijë, përforsimi i dukshëm e emisioneve argëtuese, muzikore dhe humoristike, si dhe i emisioneve të huazuara (filmat, serialet, programet muzikore, ngjarjet e rëndësishme ndërkombëtare në të gjitha fushat...) janë disa nga të arriturat e Televizionit të Kosovës për vitin 2003.

Ajo që veçanërisht vlen të përmendet është ngritja e cilësisë dhe sasisë së emisioneve dhe transmetimeve sportive në pjesën e dytë të vitit 2003.

Fillimi i transmetimit të magazinës javore në gjuhën rome, YEKHIPE, është edhe një hap në përmbushjen e obligimeve të Televizionit të Kosovës në kuadër të zhvillimit të programeve për komunitetet etnike. Gjuha rome është gjuha e pestë në të cilën Televizioni i Kosovës transmeton program.



Bashkëpunimi programor i Televizionit të Kosovës me OSBE-në, UNMIK-un, KFOR-in si dhe me institucionet vendore ka qenë në nivel mjaft të lartë. Në këtë kuadër duhet përmendur që Televizioni Kosovës ka transmetuar rregullisht të gjitha shpalljet me interes publik të institucioneve të lartpërmendura. Po ashtu me shumë sukses janë realizuar edhe emisionet **Dosia e Krimin** dhe **Ekonomia e re** në bashkëpunim me TV UNMIK-un.

Edhe gjatë këtij viti RTK-ja ka vazhduar ti transmetojë drejtpërdrejt të gjitha seancat e Kuvendit të Kosovës.

Kontrata EBU – RTK, e nënshkruar në janar të vitit 2003, ka një rëndësi të veçantë për RTK-në, sepse i mundëson qasje në programe jashtëzakonisht cilësore me kosto të volitshme për orë të programit si dhe përkrahje të shumanëshme dhe cilësore në të gjitha fushat e veprimtarisë.

Në këtë kuadër, mjafton të përmendet një numër jashtëzakonisht i madh i programeve edukative dhe programeve për fëmijë.

Në vijim është paraqitur diagrami i strukturës programore të emetuar në TV, si dhe e origjinës së programeve të ementuar.



Themelimi i orkestrës reviale të RTK-së **BIG BEND**, është edhe një e arritur e rëndësishme gjatë këtij viti.

Në këtë vit Televizioni i Kosovës ka punuar intenzivisht dhe ka kryer të gjitha parapërgatitjet për startim të sukseshëm të skemës së re 24 orëshe në fillim të vitit 2004. Të gjitha këto e bëjnë RTK-në kanal më cilësor, më të shikuar dhe më të besueshëm në Kosovë.

LAJMET

Gjatë vitit 2003, edicionet e lajmeve të Televizionit të Kosovës kanë shënuar, përgjithësisht, një përparim të caktuar cilësor dhe sasior.

Edicionet e lajmeve në TVK prodhohen nga stafi i gazetarëve të brezit të ri, mbështetur në standardet bashkëkohore të gazetarisë profesionale.

Më 7 prill 2003 ka startuar edicioni i lajmeve të ditës, INFO. Ky edicion ka startuar në mënyrë të suksesshme me terminin e emetimit në ora 16:00.

Një seri hulumtimesh të shikueshmërisë e të besueshmërisë, të kryera gjatë vitit 2003 nga agjenci të ndryshme, si ajo e IREX-it, e "Index Kosova" dhe "Gani Bobi", tregojnë për shikueshmërinë dhe besueshmërinë më të lartë të edicioneve të lajmeve të Televizionit të Kosovës, veçanërisht të lajmeve qendrore të orës 19:30, krahasuar me dy televizionet tjera me frekuenca kombëtare. Rezultatet e këtyre hulumtimeve dëshmojnë për cilësinë e lartë të punës, angazhimin e madh dhe përkushtimin ndaj normave profesionale të stafit të dhomës së lajmeve. Rezultatet e këtyre hulumtimeve po ashtu dëshmojnë se lajmet e TVK-së janë jo vetëm produkti më i rëndësishëm por edhe produkti më i suksesshëm i shtëpisë sonë mediale.

Po ashtu, vlen të përmendet se shpërblimi vjetor për gazetari gjurmuese televizive, i ndarë nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, i ka takuar gazetarit tonë Fatos Bytyçit. Këtë shpërblim Televizioni i Kosovës dhe po i njëjti gazetar e merr për herë të dytë radhazi.

Edicioni tjetër i lajmeve të orës 23:00, Blic, ka vazhduar ta ruajë nivelin e korrektësisë së përpunimit dhe paraqitjes të lajmeve të ditës.

Për dallim nga viti paraprak, në vitin 2003, në dhomën e lajmeve, edicionin qendror të lajmeve e ka drejtuar një staf editorial i përbërë prej tre redaktorëve, ndërkohë që edhe në edicionet tjera përgjegjësia editoriale është ndarë në më shumë redaktorë.

Në përgjithësi, heqja dorë nga koncepti i gazetarisë pasive dhe kalimi në konceptin e mbulimit aktiv të ngjarjeve dhe të dukurive, si prioritet kryesor gazetaresk dhe editorial i vitit 2003, është realizuar në një masë të caktuar.

Kultivimi i gazetarisë aktive mbetet një synim i përhershëm i stafit editorial dhe menaxhues të TVK-së.

Kufizimet buxhetore të RTK-së kanë bërë që stafi i dhomës së lajmeve gjatë vitit 2003 të mos shtohet dukshëm në numër. Kjo ka limituar në masë të rëndësishme synimet e përgjithshme editoriale dhe menaxheriale për profilizimin e stafit të dhomës së lajmeve.

PROGRAMI INFORMATIV

Programi informativ mbetet njëri prej segmenteve të rëndësishme komplementare me dhomën e lajmeve si hapësirë programore për zgjerimin dhe thellimin e informacioneve. Programi informativ synon që në mbulimin e çështjeve aktuale të përfshijë llojllojshmërinë e opinioneve në trajtimin e problemeve të shumta politike, sociale e ekonomike.

Me qëllim të informimit më të plotë të audiencës me rrjedhat politike vendore Televizioni i Kosovës i ka transmetuar të gjitha seancat e Kuvendit të Kosovës, në rrjetin tokësor dhe në atë satelitor dhe atë me buxhet të vetin. Pos kronikave në edicionet informative, janë përgatitur edhe emisione të veçanta 20 - 30 minutëshe nga shumë seanca të Kuvendit.

Programi informativ i Televizionit të Kosovës i kushton rëndësi të veçantë edhe rrjedhave politike ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Kosovën, për ç'arsye janë transmetuar drejtpërdrejt mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në të cilat janë paraqitur raportet për gjendjen në Kosovë, po ashtu me buxhet të RTK-së.

Programi informativ në përpjekje të mbulimit sa më të gjithanshëm të aktualitetit është konceptuar ashtu që përveç emisioneve të rregullta javore informative si dhe cikleve të emisioneve debatuese tematike, të mbulojë ngjarjet dhe rrjedhat aktuale edhe me emisionin **Aktualitete** si emision jashtë termineve të rregullta si dhe me edicionin **Speciale**.

Emisionet e rregullta javore informative vazhdojnë të jenë emisione boshte të cilat për nga struktura dhe formati janë të konceptuara ashtu që të mund të plotësojnë nevojat e shumta të audiencës për informim të plotë me aktualitetin.

Emisioni debatues **Drejtëpërdrejt** ka ftuar në studio personalitete të shquara të skenës politike vendore, si dhe zyrtarët më të lartë ndërkombëtarë në Kosovë, intelektualë, analistë, gazetarë përfaqësues të shoqërisë civile etj. ku janë trajtuar çështjet e shumta nga këndvështrime të ndryshme.

Pro et contra trajton tema e probleme kontraverze dhe delikate aktuale.

Në **Intervistën e javës** ishin personalitete më të shquara-ndër të cilët udhëheqës të institucioneve të Kosovës, përfaqësues partiakë dhe personalitetet më të shquara të jetës publike.

Ekonomia si pjesë e rëndësishme e aktualitetit është trajtuar po ashtu në programin informativ të Televizionit të Kosovës i cili ka ofruar një laramani alternative me emisionet javore, që janë alternuar, si **Ekonomia dhe biznesi**, **Bilans plus**, **Ekonomia e re** (produksion i UNMIK). Në këtë kontekst duhet veçuar edhe përqëndrimin në problematikën e zhvillimit të agrobiznesit në emisionin javor **Bujku**.

Kultivimi i tolerancës në raportet ndëretnike në Kosovë ka vazhduar të jetë çështje me rëndësi të veçantë për Televizionin e Kosovës. Sensibilizimi i opinionit për çështjet në fjalë është bërë në emisionin **Toleranca dhe bashkëjetesa** që është transmetuar në alternacion me **Hapat**. Përderisa **Toleranca dhe Bashkëjetesa** ka afirmuar tolerancën ndëretnike dhe i ka shtruar çështje specifike që kanë të bëjnë më pozitën dhe perspektivën e komuniteteve të ndryshme në Kosovë, në emisionin **Hapat** janë trajtuar tema që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, përgjithësisht, me theks te disa kategori të rrezikuara të popullsisë.

Edhe diaspora shqiptare nuk ka mbetë jashtë trajtimit në programin informativ të Televizionit të Kosovës të cilës i është kushtuar emision i veçantë **Zëri ynë**.

Gjatë vitit 2003 ka vazhduar trajtimi i sukseseve, sfidave dhe vështirësive me të cilat janë përballur Trupat e Mbrotjes së Kosovës në emisionin dyjavor **Në mbrojtje të Kosovës**.

Bashkëpunimi i RTK-së me televizionet rajonale në projektin e Deutsche Welle që ka rezultuar me emisionin mujor **Periskopi** ka vazhduar edhe gjatë vitit 2003.

Programi informativ i Televizionit të Kosovës ka reaguuar edhe me mbulime speciale dhe të drejtëpërdrejta të shume ngjarjeve të veçanta: janë transmetuar drejtëpërdrejt disa akademi përkujtimore, kushtuar përvjetorëve të ngjarjeve dhe personaliteteve të shquara; janë transmetuar drejtëpërdrejt ceremonitë fetare me rastin e festave të Bajramit dhe të Kërshëndellave dhe po ashtu ka vazhduar me përgatitjen e emisionit gjithëditor – informativ- zbavitës, me rastin e 28 Nëntorit, me pjesëmarrës të shumtë dhe program të larmishëm, me kronika të shumta nga terreni dhe me raporte të korrespondentëve.

Në pjesën e dytë të vitit 2003 është shënuar një kthesë pozitive, si në pikëpamje të cilësisë ashtu edhe të sasisë së programeve sportive.

Për shkak të interesimit të madh të audiencës për sport, në strukturën programore të Televizionit të Kosovës programet sportive kanë një vend të posaçëm. Televizioni i Kosovës tani është televizioni kosovar me mbulimin më të madh të ngjarjeve sportive. Redaksia e sportit është përkujdesur që në programin e vet të ketë të gjitha ngjarjet më të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare.

Krahas programit të pasur sportiv me transmetime të drejtëpërdrejta, televizioni i Kosovës është i përkushtuar në shtimin e emisioneve sportive duke tejkaluar dhe përmbushur kështu dobësitë dhe zbrastësitë e evidentuara të vitit të kaluar me

emisione përcjellëse analitike sportive. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka basketbolli kosovar për audiencën Televizioni i Kosovës ka startuar me emisionin e ri kushtuar basketbollit **Time out**. Po ashtu është bërë një depërtim i madh edhe në emisionet për futbollin me përgatitjen e emisioneve 30 minutëshe nga futbollit ndërkombëtar: **Futbolli spanjoll** dhe **European football show**.

Risi në programin sportiv të TVK-së ka qenë emetimin i ligës më të fortë dhe më atraktive të basketbollit në botë - NBA.

Televizioni i Kosovës ka mbuluar ngjarjet sportive vendore si garat për kampionat dhe Kup të Kosovës në basketboll, ka mbuluar edhe ndeshjet e KB Universiteti në garat ndërkombëtare në konkurrencën e femrave, si dhe ndeshjet kampionale të Volejbollit. Në vitin 2003 i është dhënë hapësirë edhe afirmimit të tenisit duke mbuluar turneun vendor Dielli Open.

Nga ngjarjet ndërkombëtare që duhet veçuar janë: ndeshjet e kombëtares së Shqipërisë, Kupa e UEFA-së, Premier liga angleze, të gjitha meçet e Luan Krasniqit si dhe meçe tjera ndërkombëtare si dhe kampionati botëror dhe liga e artë e atletikës.

KOMUNITETET ETNIKE

Gjatë vitit 2003 janë përmbushur objektivat e përcaktuara themelore programore nga redaksitë në gjuhët e komuniteteve etnike. Me qëllim të integritimit të numrit më të madh të komuniteteve etnike në Televizionin e Kosovës gjatë vitit 2003, në muajin shtator ka filluar të transmetohet edhe një emision në gjuhën rome – **Yekhipe**. Ky projekt, për ciklin e parë të emetimit, realizohet me përkrahjen e Zyres zvicerane në Prishtinë. Projekti ka filluar në muajin qershor. Gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht 2003 është bërë trajnimi i redaksisë rome, ndërkaq transmetimi ka filluar në muajin shtator. **Yekhipe** është emision javor. Transmetohet çdo të enjte. Kohëzgjatja e emisionit është 20 min. RTK-ja ka marrë obligim që këtë program pas periudhës 1 vjeçare ta vazhdojë me mjete të veta buxhetore.


Redaksitë në gjuhën serbe, në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke kanë përgatitur dhe transmetuar 5 herë në javë emisionet informative të lajmeve, në kohëzgjatje prej 10 minutash dhe emisionet javore **Nedeljni kolaz**, **Mostovi** dhe **Mozaik**, në kohëzgjatje prej 45 minutash.

Në vitin 2003 është shënuar një ngritje e cilësisë së programeve në gjuhët e komuniteteve. Konsolidimi i ekipit xhirues ka mundur punën e shtuar në terren. Edhe redaksia në gjuhën serbe e ka shtuar punën në terren si rezultat i përmirimit të situatës së sigurisë në Kosovë. Është shtuar numri i gazetarëve në redaksitë serbe, turke dhe boshnjake, si dhe numri i korrespondentëve nga terreni.

Në vitin 2003 poashtu është punuar një projekt shumë ambicioz për prodhimin e programeve për fëmijë në gjuhët e komuniteteve. Ky projekt parasheh realizimin e pesë emisioneve javore për fëmijë dhe tashmë i është dorëzuar donatorëve të mundshëm. Realizimi i këtij projekti pritet në vitin 2004, varësisht nga donacionet.

Poashtu për herë të parë Televizioni i Kosovës gjatë vitit 2003 ka emëruar një producent të veçantë ekzekutiv të programeve të komuniteteve. Ky vendim ka rezultuar me një cilësi më të lartë të punës dhe një koordinim shumë më efikas.

RTK-ja vazhdon përpjekjet për të arritur synimin që 15% e programeve të jetë në gjuhën e komuniteteve. Përqindja e lajmeve në gjuhët e komuniteteve ndaj lajmeve në tërësi, gjatë vitit 2003 tashmë ka arritur 35% (shih diagramin në vijim!).



Në këtë kontekst, kanali i dytë terestrial për RTK-në, veç tjerash, do të lehtësonte në masë të madhe edhe këtë synim.

PROGRAMI I MËNGJESIT

Programi i mëngjesit vazhdon të jetë komponentë e rëndësishme programore e Televizionit të Kosovës. Karakteri i drejtëpërdrejtë ditore i këtij programi e bënë të jetë ndër programet me rëndësi të posaçme informative, në përmbushjen e nevojave të informacionit servisitor ditore për audiencën. Mirëmëngjesi Kosovë ka një format atraktiv edhe me elemente tjera argëtuese gjë që e bënë të afërt për një auditorium të gjerë. Gjatë vitit 2003 është shënuar një konsolidim i programit **Mirëmëngjesi Kosovë**, është bërë një avansim i dukshëm në komponentën vizuale (ndryshimi i skenografisë, shpicës lajmëruese e deri tek xhinglat e rubrikave), si dhe pasurim përmbajtësor me futjen e rubrikave të reja. Natyrisht, është ruajtur struktura primare e konceptit si një program informativo-argëtues. Bazuar në sondazhet e organizuara nga asociacionet e specializuara qoftë ndërkombëtare, qoftë kosovare, Programi i Mëngjesit, rezulton të jetë ndër programet më të shikuara të RTK-së dhe në krahasim me programet konkurente ka një shikueshmëri shumë të madhe. Këtë e vlerësim të lartë të audiencës programi i mëngjesit e ka arritë duke pasur vazhdimisht një përmbajtje dhe tematikë aktuale, duke reaguar me shpejtësi ndaj ngjarjeve të rëndësishme dhe çështjeve me interes për shikuesit.

PROGRAMI KULTUROR-ARSIMOR

Programi Kulturor Artistik, Dokumentar, Arsimor dhe për Fëmijë, me një strukturë të gjerë përmbajtjesh programore, edhe gjatë vitit 2003 i ka realizuar në tërësi përcaktimet programore. Spektri i gjerë i emisioneve të reja të startuara në vitin 2003 vetëm sa e kanë përforcuar orientimin e këtij segmenti programor për gjithpërfshirshmëri në trajtimin e çështjeve me rëndësi për transmetuesin publik, siç janë kultura dhe arti.

Në vitin 2003 është bërë një avansim i dukshëm përmbajtësor në përmbushjen e strukturës programore me programe të rregullta cilësore dokumentare. Dokumentarët **Diku në Kosovë** dhe **Paradoksi**, me komponentat e tyre përmbajtësore dhe vizuale kanë kontribuar majft në arritjen e cilësisë së synuar televizive të këtij segmenti programor. Dokumentari **Etnika** po ashtu me një koncept atraktiv ka arritë që shumëçka nga etnosi shqiptarë, zejet, shkathtësitë dhe krijimi tradicional t'i bëjë të afërta për auditorin. Janë arritë edhe disa

suksese në sferën e Programit dokumentar, qoftë me prodhime vetjake, apo në koproduktion, siç janë dokumentarët: **Loti, Kufinj të Kosovës** (të dy këta filma u shfaqën dhe u pritën mire edhe në Festivalin e filmit dokumentar për të drejtat e njeriut), disa dokumentarë kushtuar dëshmorëve dhe martirëve të lirisë. Duhet veçuar ciklin e dokumentarëve **Jashtë kornizave** në koproduktion me Kalimin e Urave i cili ka pasë sukses të veçantë dhe i cili tashmë ka siguruar mjete nga donatorët e huaj për përfshirjen regjionale në tematikën e tyre.

Emisionet dokumentare të ciklit **Ngjyra jete** tashmë janë ndër më të shikuarat dhe më të mirëpriturat tek audiencia më e gjerë.

Në vitin 2003 është startuar edhe me një emision për art **Aveny** i cili me formatin e tij ka përbushë nevojën për mbulimin e krijimtarisë alternative artistike në Kosovë dhe në botë. Emisionet për kulturë tashmë të rregullta si: **Kult, Dialog Plus, Pro arte, Familja, Drama Televizive, Teatri në ekran** krijojnë hapësirë për trajtimin e gjithanshëm të kulturës, artit dhe letërsisë në Kosovë dhe më gjerë.

Televizioni i Kosovës ka vazhduar me realizimin e projekteve speciale në kulturë. Veçojmë programin shtatë orësh të drejtpërdrejtë nga Prizreni për nder të 125 vjetorit të LSHP-së (program ky i realizuar në bashkëpunim me segmentet tjera programore të TVK-së), programin special më se tre orësh, nga mjediset e Kinemasë **ABC** të kryeqytetit, kushtuar dokumentarit të regjisorit shqiptar Vladimir Priftit dhe krijimtarisë së tij, etj.

RTK-ja, në skemën e vet programore ka tashmë edhe një Program të konsoliduar Arsivor me përmbajtje programore edukative arsimore. Në ciklin e parë semestral janë transmetuar programe të sajura nga prodhimet vetiake dhe ato të huajtura, kurse në ciklin e dytë, shtator – dhjetor 2003, përveç dy emisioneve – njëri për gjuhën gjermane, e tjetri për atë italiane, të gjitha emisionet tjera qenë prodhim i RTK-së. Zgjuan interesim të auditorit veçanërisht emisione **Fizika interaktive, Artet, Letërsia, Informatika aplikative, Medika, Ora e botanikës**, etj. Aktualisht kemi pra përmbajtje arsimore nga gjuha dhe kultura e gjuhës, nga letërsia dhe artet, nga informatika me kompjuteristikë, nga shkenca dhe mjekësia, edukimi qytetar, kurset e gjuhëve të huaja, etj. Të gjitha këto përmbajtje programore arsimore transmetohen çdo ditë, nga e hëna deri të premten dhe mbulojnë harkun kohor një orësh, duke filluar prej orës 10.05 minuta.

Vëllimi programor kushtuar fëmijëve, gjatë vitit 2003 thuajse është trefishuar, fillimisht me prodhime vetiake, por edhe me ato të huajtura e me postproduktion tonin. Prej dy emisioneve origjinale në vitin paraprak, (**Fjolla** dhe **Kutia magjike**), në vitin 2003 janë realizuar edhe me emisione të reja për fëmijë (**Unë e di, po ti, Takimi me shkrimtarin**, Kuizi për fëmijë **1,2,3, fillo**, dy edicione javore **Fëmijët këndojnë**).

PROGRAMI ARGËTUES DHE MUZIKOR

Televizioni i Kosovës si transmetues publik i kushton mjaft rëndësi argëtimit. Ky segment programor duhet të përbushë nevoja të llojllojshme të audiencës së përgjithshme në Kosovë; prej muzikës klasike, asaj argëtuese deri tek ajo popullore. Televizioni i Kosovës në këtë segment programor ka bërë zgjerime të dukshme në përfshirjet e zhanreve të ndryshme muzikore.

Në vitin 2003 Televizioni i Kosovës shënon ngritje cilësore për sa i përket transmetimit dhe prodhimit të programeve argëtuese. Në vitin 2003 është startuar me emisionin atraktiv **Multimedia** i cili me kombinimin e përmbajtjeve edukative dhe argëtuese është treguar mjaft i suksesshëm.

Cikli i ri i emisioneve muzikore **RTK Live & Unplugged** ka qenë një nga risitë programore për të gjithë adhuruesit e pop-rock muzikës, sidomos për ata që adhurojnë muzikën "pa rrymë". Koncertet e Lenny Kravitz, Mariah Carey, Erykah Badu, Bjork, Depeche Mode, Bon Jovi, Prince, David Bowie dhe të shumë yjeve tjera të pop-rock skenës botërore janë transmetuar nga Televizioni i Kosovës.

Edhe gjatë këtij viti Televizioni i Kosovës ka transmetuar Koncertin e Vjenës të Vitit të ri, Ndarjen e çmimit Oskar, Këngën e Eurovisionit, BAFTA, "vallëzuesit e rinj evropian", etj.

RTK-ja ka vazhduar me transmetimin e drejtpërdrejt të shumë ngjarjeve muzikore; duke filluar nga koncertet e Filharmonisë së Kosovës e deri te koncertet e muzikës argëtuese e popullore. Në këtë kuadër do përmendur edhe transmetimin e spektakleve të mëdha si koncerti tashmë tradicional ne organizim te RTK-se - koncerti i 4 korrikut në qendër te Prishtinës, Tung Amerikë.

RTK si transmetues publik, ka ofruar edhe program kulminant të muzikës klasike, të përformuesve më të mire botëror, por edhe atyre vendor.

Ritmet popullore dhe **Gurra** vazhdojnë të plotësojnë kërkesat e shumta për muzikën kualitative popullore dhe folklorike.

Ndër sukseset më të mëdha të Televizionit të Kosovës pa dyshim është seriali i parë vendor pas luftës **Familja moderne**. Ky serial u shndërrua ndër programet më të shikuar në Kosovë, mbase më i shikuari. Dëshmi janë 31 episodat e emituara, dhe te reprizuara ne kuader te Programit te nates së Televizionit të Kosovës gjate verës 2003. Sezoni i dytë i serialit **Familja moderne** ka filluar së emituari në nëntor 2003.

Programi filmik dhe serialet në Televizionin e Kosovës, gjatë vitit 2003, ka vazhduar me trendin e transmetimit të serialeve kulminante amerikane në terminin e orës 21:00, si dhe nga një film në orët e vona të mbrëmjes. Televizioni i Kosovës ka transmetuar kult serialin amerikan **Seksi dhe qyteti** dhe serialet **Crime Scene Investigation (C.S.I.)** dhe **JAG**. Televizioni i Kosovës vazhdon t'i përmbahet qëndrimit për mosmetimin e serialeve apo programeve tjera me vlera të dyshimta.

PROGRAMI I VITIT TË RI


Edhe në vitin 2003, RTK-ja ka transmetuar program, pothuajse pa asnjë reprizë dhe pa ndërprerje gjatë tri ditëve të festës së Vitit të ri.

Sasia dhe kualiteti i prodhimit, ka qenë i një niveli dhe cilësie mjaft të lartë. Programi i Vitit të ri 2003/2004 është ndërtuar mbi bazat e një koncepti të ri programor, që ka mundësuar funksionim shumë të mirë të të gjitha tërësive programore, duke filluar nga programi i mëngjesit, që ishte i rikonceptuar enkas për ditët festive, me shumë mysafirë, këngë dhe rubrika speciale. Kombinimi i prodhimit tonë të programeve për fëmijë me filma të huazur artistik, u ka mundësuar fëmijëve të shohin dhe të kënaqen me diçka të mirë për ta në këto ditë feste. Edicioni festiv i serialit shumë të popullarizuar, **Familja Moderne**, dhe më pas pikat humoristike si dhe muzikore të këngëtarëve më të mirë kosovarë, të zgjedhur me kriteret e larta profesionale, maratona filmike gjatë tri netëve të festës, pastaj transmetimi i koncertit tradicional të Vjenës dhe programet muzikore zbavitëse në gjuhën serbe, turke dhe boshnjake vetëm sa e kanë ngritur edhe më shumë cilësinë dhe laryshinë e programit të Vitit të Ri.

SHIKUESHMËRIA

Sipas hulumtimit të bërë nga qendra për studime humanistike "Gabi Bobi" RTK-në e shikojnë 95.0 % të respondentëve.


Në kategorinë e *shikueshmërisë së rregulltë* (zgjedhja e parë plus zgjedhja e dytë) **Televizioni i Kosovës** prin me 80.2 % .



Në kuadër të shikueshmërisë së përgjithshme, **Televizioni I Kosovës** është e para me 95.1 %.

Në mëngjes **Televizioni i Kosovës** shënon maksimumin e shikueshmërisë në krahasim me televizionet tjera.

Ai shikohet nga 92 % e audiencës së përgjithshme.



Gjithnjë sipas këtij hulumtimi të gjërë programet informative të **Televizionit të Kosovës** janë bindshëm më të shikuara dhe më të vlerësuara se programet informative të televizioneve tjera.

Programet informative të **Televizioni të Kosovës**, sipas zgjedhjes së parë, i përcjellin 59.6 % të respondentëve.

Edhe rezultati kumulativ i përcjelljes së programeve informative (zgjedhja e parë plus zgjedhja e dytë) pokështu tregon epërsinë e dukshme të **Televizionit të Kosovës** (88.9 %) në krahasim me **KTV**-në (53.5 %) dhe **TV 21**-shin (43.2 %).


Televizioni I Kosovës prin edhe sa i përket shpejtësisë, plotësisë dhe objektivitetit të programeve informative.

Në të gjitha këto kategori programi informativ i **Televizionit të Kosovës** vlerësohet si më cilësori.

Sa i përket *shpejtësisë* **Televizioni i Kosovës** përkrahet me 80.2 %, përnga *plotësia* vlerësohet se ka informata më të plota nga 76.0 % e respondentëve, ndërsa sa i përket objektivitetit vlerësohet me 73.0 %.

Respondentët kanë vlerësuar mjaft lartë ofertën programore të **Televizionit të Kosovës** sipas zhanreve.

Më shumë është vlerësuar **Programi argëtues / muzikor**, me 66.6 % dhe pastaj vijnë me rradhë **Programi informativ** me 65.0%, **Filmi** me 56.2%, **Sporti** me 55.1 %, **Programi Edukativ** me 53.6 %, **Programi Kontaktues/Debatues** me 53.2%, **Programi Rinor** me 52.6%, **Programi Kulturor/Artistik** me 52.1%, **Programi i Serieleve** me 52.0%, dhe **Programi për fëmijë** me 41.6%.



SHPËRBLIMET

- Shpërblimi vjetor për gazetari gjurmuese televizive, i ndarë nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, i ka takuar gazetarin Fatos Bytyçit
- Dokumentari televiziv i vitit shpërblim i ndarë nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës i ka takuar dokumentarin **Diku në Kosovë**

WWW.RTKLIVE.COM

Faqja në pjesën e parë të vitit 2003 e deri në muajin tetor përmbante informacione të përgjithshme për RTK-në, lajme ditore, video lajme me kualitet të lartë, si dhe rubrikat mbi emisionet e RTK-së. Gjithashtu janë bërë shumë anketa mbi çështje të rëndësishme të cilat e kanë preokupuar Kosovën dhe RTK-në.

Nga aspekti teknik faqja ka pasur vetëm një server me kapacitet të mjaftueshëm. Emisionet më të shikuara në këtë periudhë ishin **Ditari i stupcave** dhe seriali i parë vendor **Familja moderne**.

Prej janarit të vitit 2003 deri më 28 korrik 2003 faqja ka pasur **1.248 452** vizitorë.

Pra për një vit pune, faqja e RTK-së ka pasur në përgjithësi **2,355,297** vizitorë me **29,912,279** faqe të shikuara.

Gjithsej në këtë periudhë janë bërë 36 anketa, dhe 43 tema të komenteve për probleme të ndryshme në Kosovë dhe botë. Lajmet me tekst freskohen shpesh, varësisht nga dinamika e ngjarjeve. Përveç video lajmeve ditore si **Lajmet e mëngjesit, Info**, lajmet e komuniteteve **Vesti, Vijesti, Haber, Lajmet dhe Blic**, janë lansuar edhe emisionet **Ditari i stupcave, Familja moderne, Meselation, Frekuenca e Quzës, Paradox**, si dhe të gjitha emisionet speciale, si intervistat e rëndësishme etj.

Faqja **rtklive** ka dy linka të radiove tona: **Radio Kosova** dhe **Blue Sky** në të cilat vizitorët mund të kyqen drejtpërdrejt. Gjithashtu faqja ka kontribuar në disa emisione të drejtpërdrejta me pyetjet për mysafirët e ftuar.

Që nga tetori i vitit 2003 faqja e internetit e RTK-së, është ridizajnuar dhe rikonceptuar. Ajo është pasuruar me rubrika të reja, të cilat e bëjnë këtë faqe atraktive, dhe shumë të vizituar sidomos nga diaspora shqiptare, e cila e konsideron dritare të informacionet për ngjarjet në Kosovë.

Faqja kryesore përmban linkun e lajmeve, programit, interaktive, arkivën dhe rubrikën **Për ne**. Anash është futur rubrika **Informatori** e cila është e konceptuar për të sjellur informacione nga teatri, kinemaja dhe aeroporti. Ndërsa në anën e majtë, navigimi i lajmeve, këndi i videolajmeve, pasqyra e shtypit, skema programore, informacioni për energjinë elektrike dhe moti.


Lajmet ditore azhurohen sipas nevojës. Shpejtësia e lajmit është maksimale.

Në faqet interaktive janë futur rubrika që kanë zgjuar kërkimin e vizitorëve. **Ju pyetni...** është rubrika e cila ka bërë bum, që nga lansimi i faqes së re. Mysafir i parë i kësaj rubrike ishte z. Adem Demaçi. Vizitorët e faqes sonë i kanë bërë zotit Demaçi më se 350 pyetje. Ndërkohë mysafir i kësaj rubrike ishte edhe kryeadministratori i Kosovës, z. Harri Holkeri, ndërkaq interesimi ishte i jashtëzakonshëm dhe numri i pyetjeve jashtëzakonisht i madh.

Përpos kësaj forumi i faqes së internetit është ndër të më vizituarit. Forumi ka shumë anëtarë të cilët hapin tema të ndryshme për të diskutuar duke filluar nga çështjet politike e deri te temat mbi sportin e më të rejtat në botën e informatikës.

Rubrika të tjera tërheqëse janë **aforizmi i ditës, karikatura e ditës, dhomat e diskutimit, këshilla praktike, gatojca, opinione, letrat e lexuesve, horoskopi javor, kuriozitetet** e shumë të tjera.

Numri i përgjithshëm i vizitorëve për vitin 2003 ishte **2,410,410**. Mesatarja mujore e numrit të vizitorëve është **200.867.5** me gjithsej **300.000** faqe të shikuara.



Në muajtë e fundit të vitit prej se është lansuar faqja e re ka pasur rritje enorme të vizitueshmërisë.

Në vitin 2003 faqja është forcuar edhe me nje gazetare. Ndërkohë që teknikisht është avancuar mundësia e lansimit të emisione me video fajla me zgjerimin e kapacitetit teknik në tre serverë.

Ambicjet për të bërë një faqe të internetit sa më të vizituar dhe profesionale nuk përfundojnë këtu. Mëtohet për rritjen e kapaciteve teknike, si dhe begatimin dhe freskimin e faqes me ide e rubrika të reja.

OPERACIONET DHE TEKNIKA

Gjatë vitit 2003 janë bërë disa përparime të rëndësishme në njësinë e operacioneve dhe të teknikës së RTK-së:

- **Rritja e besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike**, duke e lidhur sistemin energjetik të TV në pjesën e rrjetit të qytetit pa restriksione. Kjo ka rezultuar në zvogëlimin e dukshëm të shpenzimeve për karburante dhe në zgjatjen e jetës së pajisjeve për sistem ndihmës energjetik (UPS, gjeneratorë etj.).
- **Rritja e kapaciteteve për prodhimin e programit vetanak**, që është bërë me adaptimin e depos në studio provizore për xhirimin e serialit "Familja Moderne".
- **Aktivizimi i Qendrës Servisore (QS) të RTK-së në bashkëpunim me UNDP**, në saje të donacionit të qeverisë japoneze.
- **Rritja e kapaciteteve për disenj grafik** që është bërë me instalimin e një stacioni të fuqishëm grafik të bazuar në teknologjinë e firmës "Matrox",
- **Kompjuterizim i procesit të emetimit** me ndihmën e video-serverit që paraqet hap të parë në drejtim të kompjuterizimit të programeve të lajmëve.
- **Implementimi i statistikës në transmetimet e lojës së basketbollit** e ka ngritur dukshëm nivelin e përgjithshëm të transmetimeve të kësaj loje, me disenj dhe teknike të nivelit më të lartë.
- **Kamera me teknikën "pa tela"** është bërë pjesë përbërëse e arsenalit të transmetimeve nga terreni.

Të gjitha këto avancime janë bërë me investime minimale të cilat praktikisht janë kompensuar në mënyrë të tërthortë me kursime në shpenzimet e karburantit, kursime në mirëmbajtjen e pajisjeve energjetike, ngritje të dukshme të efikasitetit të punës në prodhimin e serialit "Familja Moderne". Njëkohësisht, me këtë është arritur edhe lirim i kapaciteteve prodhuese për programe tjera vetanake, që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të programit të RTK-së.

REKAPITULIM I VEPRIMTARISË OPERATIVO-TEKNIKE

Në vazhdim është paraqitur një pasqyrë tabelare e veprimtarisë operativo-teknike në TVK gjatë vitit 2003.

Numri i xhirimeve dhe transmetimeve të drejtëpërdrejta në studiot dhe autoreportazh sipas muajve

	PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	GJITHSEJ EMISIONE TË XHIRUARA
1	Në të dy studiot / Xhirime	65	68	95	86	69	70	59	52	75	82	67	79	867
2	Në të dy studiot / Drejtëpërdrejtë	15	18	26	47	41	41	32	40	47	43	46	46	442
3	Autoreportazhi / Xhirime	0	1	3	5	6	7	4	6	3	10	9	25	79
4	Autoreportazhi / Drejtëpërdrejtë	4	8	16	14	13	19	8	2	13	13	16	11	137

Realizimi i prodhimit sipas muajve në orë të programit

	PËRSHKRIMI	JANAR	SHKURT	MARS	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	GJITHSEJ ORË TË REALIZUARA
1	Në të dy studiot / Xhirime	85.0	82.0	95.0	112	116	112	79.4	62.3	54.0	94.0	96.3	86.3	106	1181.3
2	Në të dy studiot / Drejtpër-drejtë	13.2	19.3	26.0	24.2	30.0	23.2	21.1	14.3	21.0	26.4	22.1	35.2	23.5	299.5
3	Autore-portazhi /xhirime	0.0	4.0	3.0	8.0	14.0	18.0	24.0	12.0	20.0	13.0	33.0	32.0	162	343.0
4	Autore-portazhi /drejtpër-drejtë	13.0	18.0	16.0	42.0	38.0	33.0	49.0	23.0	6.0	40.0	35.3	41.0	30.0	384.3

PROGRAMET INFORMATIVE

Realizimi i gjithmbarshëm në orë të programit

	PËRSHKRIMI	Janar -Dhjetor /Orë të transmetuara
1	Programi i mëngjesit	912.5
2	INFO	70.15
3	Lajmet në gjuhën e komuniteteve	172.3
4	LAJMET –Qendrore	182.5
4	BLIC	92.25
	Gjithsej	1429.7

NJËSIA E SUBTITLIMIT*Realizimi i gjithmbarshëm në orë të programit*

	PËRSHKRIMI	Kohëzgjatja / min	JANAR -DHJETOR / EMISIONE TË TITRUARA	TOTAL / ORË
1	FILMA	94' - 120'	295	529.30
2	Filma te animuar	120'	3	3.00
3	Seriale	50'	368	307.00
4	Dokumentar	50'	92	77.00
5	Dokumentar sportiv	30'	48	24.00
6	KATALOG	60'	22	22.00
7	Mjuzikëll	60'	2	2.00
8	PROMO	5'	1	0.05
	Gjithsej		831	964.35

RADIO

Radio Kosova dhe Radio Blue sky janë pjesë vitale e RTK-së si transmetues publik. Të dy radiot poashtu janë të ndërtuara mbi parimet e transemtuesit publik i cili i ofron audiencës programe cilësore informative, edukative dhe argëtuese. Dy radiot, Radio Kosova dhe Radio Blue Sky edhe pse punojnë mbi parimet e njëjta kanë qasje dhe profile të ndryshme që komplementohen ndër vete për tërheqjejen e një auditori sa më të gjerë. Radio Kosova i drejtohet auditorit të moshës mbi 25 vjeç, ndërsa Blue sky moshës deri në 25 vjeç. Profilizimi i këtillë i radiove përmes targetimit të grupmoshave është treguar mjaft i suksesshëm dhe funksional në atraktimin e audiencës së përgjithshme në Kosovë. Për suksesin e dëgjueshmërisë dhe besueshmërisë së radiove që veprojnë në kuadër të RTK-së dëshmojnë edhe hulumtimet e audiencës të bëra nga organizatat e ndryshme si: Index Kosova dhe Qendra për Studime Humanistike Gani Bobi. Po ashtu këtu mund të përmendet edhe Provideri Live 365 ku në mesin e 2700 radiove botërore Radio Kosova më 5 shtator 2003, në kategorinë e radiove "botërore" doli në **vendin e parë të dëgjueshmërisë në Internet** (me 48.863 orë të dëgjua në 30 ditët e fundit).

Gjatë vitit 2003 është përforcuar ndërlidhja në funksionimin e dy radiove, duke e ruajtur pavarësinë e secilës radio dhe organizimin primar në dy "dhoma të lajmeve". Kjo është bërë përmes koordinimit në nivel të redaktorëve përgjegjës i cili është intensifikuar. Ky koordinim gjatë vitit 2003 është arritur edhe me dhomën e lajmeve të Televizionit të Kosovës në formë të konsultimeve mëngjesore të redaktorëve përgjegjës. Një bashkëpunim i tillë me TV-në ka ekzistuar gjatë vitit 2003 në rastet e lajmeve të veçanta dhe speciale, por edhe i zgjeruar në punët e përditshme, sidomos në këmbim të informatave dhe mbulimin e ngjarjeve. Në fund të vitit 2003 në Radio Kosova është hartuar projekti për programin dy-orësh në gjuhën boshnjake, janë bërë përgatitjet teknike, si dhe është shpallur konkursi për angazhimin e një redaktori dhe një gazetari për redaksinë boshnjake, për startim në fillim të vitit 2004. Me këtë Radio Kosova arrinë të përmbushë obligimet e veta si transmetues publik për arsye se gjuha boshnjake është gjuha e katërt në të cilën Radio Kosova transmeton programet e veta.

Viti 2003 është vit i ndryshimit të suksesshëm të skemës programore të Radio Kosovës që ka filluar në muajin qershor.

Radio Kosova dhe Radio Blu sky ka realizuar 195 transmetime të drejtëpërdrejta gjatë vitit 2003 gjë që flet për atë se të dy radiot kanë qenë të përkushtuara në reagimin e shpejtë dhe efikas ndaj ngjarjeve të shumta.

EMISIONET INFORMATIVE DHE LAJMET

Redaksitë e informacionit të Radio Kosovës dhe Radio Blue sky kanë bashkëpunim intenziv në baza ditore: konsultë të përbashkët editoriale në mëngjes, shkëmbim të materialeve përmes rrejtit lokal që e mundëson një gjë të tillë. I përbashkët është edhe grumbullimi dhe procesimi i lajmeve. Struktura programore e dy radiove mundëson që çdo gjysëm ore në njërin nga radio-stacionet të ketë edicione informative.

Shfrytëzimi i rrjetit të përbashkët të korrespondentëve si në vend ashtu edhe në rajon, ka mundësuar që edicionet informative të RTK-Radiove të jenë më kualitative dhe efikase në mbulimin e ngjarjeve kryesore nga terreni.

Radio Kosova me 9 qershor 2003 ka startuar me skemën e re programore. Pos emisioneve të tjera të reja, janë sjellë risi edhe në emisionet informative. Kështu,

me këtë skemë gjatë ditës ka gjithsej 15 edicione lajmesh në një kohëzgjatje prej 130 minutash përkatësisht 2 orë e 10 minuta. Radio Kosova transmeton tri edicione qendrore informative: Ngjarje dite - 30 minuta, Ditari - 30 minuta dhe Kronika ditore - 10 minuta, si dhe 12 edicione lajmesh nga 5 minuta.

Me fillimin e skemës së re programore:

- Edicionet qendrore të lajmeve janë dinamizuar. Ato përfshijnë lajmet më të fundit në vend dhe botë si dhe kronika radfonike, të cilat përgatiten mirë, megjithë ngecjet në pajisjet teknike për gazetarë.

- Është bërë profilizimi i gazetarëve që po ashtu është risi, sepse më herët nuk kemi mundur ta zhvillojmë këtë proces në mungesë të kuadrit gazetaresk si dhe

- Është avancuar koordinimi funksional i të dy dhomave të lajmeve, të Radio Kosovës dhe Radios Blue Sky.

Të gjitha këto çështje programore ishin në të mirë të ngritjes e cilësisë së programit informativ në Radio Kosovë dhe në avancimin programor në përgjithësi.

PIKAT UNIKE PROGRAMORE

Radio Kosova

Radio Kosova kështu është duke i shërbyer një auditori më të gjerë dhe me laryshinë e emisioneve është bërë pjesë e përditshmërisë e auditorit në tërë Kosovën, në rajon dhe në diasporë. Në këtë prijnë edicionet e lajmeve, si dhe, në bazë të anketave programi i sportit i Radio Kosovës, si njëri nga më të dëgjuarit, pasuar nga emisionet muzikore, programet kontaktuese dhe të natës.

Radio Blue sky

Një nga pikat unike tërheqëse të Radios "Blue Sky" është transmetimi i radio-reportazheve nga jeta e përditshme e popullatës kosovare. Në kuadër të këtyre radio-reportazheve ka pasur edhe dokumentarë nga sfera të ndryshme të jetës, realizuar nga gazetarët tanë. Janë realizuar edhe emisione të tjera me tema mjaft atraktive për të rinjtë, si p.sh. emisioni "Për mbrojtje kundër sëmundjes së shekullit HIV/AIDS", emisioni për "Homoseksualët dhe pranimin e tyre nga shoqëria kosovare", për "Dukurinë e shfaqur të vetvrasjeve pas luftës në Kosovë", emisioni për jetën e ashkalinjëve dhe romëve si dhe emisioni dokumentar për "Ambientin" Natyrisht duke i mbetur besnike auditorit të saj Radio Blue sky ka transmetuar mjaft ngjarje atraktive për të rinjtë si: manifestimin e ndarjes së çmimeve të MTV-së për Britani "BRITISH AWARDS", ngjarjen e madhe të MTV-së siç është ndarja e çmimeve MOBO për muzikë të realizuara me British Council.

Në kuadër të përforsimit të identitetit të Radios Blue Sky dhe freskisë së përgjithshme në radio, është punuar në xhinglat e reja për informacion. Këto xhingla janë përgatitur nga stafi ynë teknik me pajisjet teknike dhe programet soft-verike të cilat i disponojmë në radio.

KOMUNITETET ETNIKE

Radio Kosova dhe Radio Blue sky si pjesë e transmetuesit publik janë të orientuara në integrimin sa më të madhë të komuniteteve tjera etnike në Kosovë. Këto dy radio transmetojnë program në gjuhën serbe dhe në gjuhën turke, ndërkaq, në fund të vitit 2003 e tre ka përfunduar projekti për startimin e prgramit edhe në gjuhën boshnjake që duhet të fillojë në fillim të vitit 2004.

Zgjerimi i programit në gjuhën serbe ishte paraparë të bëhej në Blue Sky ku kishte një orë e gjysmë program, prej orës 14 e deri në 15:30. Programi ishte

paraparë të zgjatej për gjysmë ore dhe implementimi i këtij objektivi ka filluar nga 9 qershori 2003, do të thotë tani kemi 2 orë program në gjuhën serbe, duke filluar nga ora 14:00 dhe duke përfunduar në orën 16:00. Me biznes plan ishte paraparë edhe punësimi i punëtorëve të ri në programin në gjuhën serbe. Vazhdon gjurmimi për të paktën edhe një gazetar serb për angazhim në programin serbisht.

Transferimi i programit në gjuhën turke nga ora 20 e 30 në orën 17 është bërë duke filluar nga 9 qershori 2003 dhe gjithashtu programi në gjuhën turke në Radio Blue Sky është transferuar në orën 16. Që nga qershori, programi në gjuhën turke në Radio Blue Sky fillon në orën 16 dhe përfundon në ora 17, ndërsa në Radio Kosovë fillon në orën 17 dhe përfundon në orën 18. Kjo ka pasur një efekt pozitiv në dëgjueshmërinë e këtij programi nga ana e dëgjuesve të komunitetit turk në Kosovë.

SHPËRBLIMET

Emisioni dokumentar i Radio Blue Sky për "Ambientin" i realizuar nga Vaide Morina, ka fituar çmimin e parë nga Ministria e Ambientit, si radio-emisioni më i mirë i realizuar në vitin 2003 në këtë temë.

Gazetarja e redaksisë serbe në Radio Blue sky Ana-mari Repic fiton çmimin e Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës për gazetari të guximshme për vitin 2003.


FAQJA E INTERNETIT NË BLUE SKY E RADIO KOSOVË

Në kuadër të plasimit sa më të shpejtë të informacioneve, gjatë vitit 2003 është punuar edhe në ëeb-faqen e internetit të Radios "Blue Sky" dhe të Radio Kosovës. Në Blue Sky, është bërë një disenj dhe kodim i tërë i faqes së re të internetit me çka është mundësuar që informacionet të përditësohen çdo minut. Zgjidhjet vizuele të faqes, përmbajtjet dhe lehtësia e qasjes, bëjnë që kjo faqe të jetë, pa dyshim, një ndër ëeb-faqet më tërheqëse të radiove kosovare në përgjithësi. Puna në ëeb-faqen e Radio Kosovës, po vazhdon. Është angazhuar edhe një gazetarë e cila aktualisht punon në redakturimin, plasimin dhe freskimin e informacioneve për të dy radiot. Në ndërkohë, ka vazhduar bashkëpunimi i ngushtë mes ekipit të web-faqeve të radiove me atë të Televizionit.

Vlenë të përmendet se në anketën e provajderit të shërbimit të strimingut të radiove "live365.com", Radio Kosova, më 5 shtator 2003, në kategorinë e radiove "botërore" doli në vendin e parë të dëgjueshmërisë në Internet (me 48.863 orë të dëgjua në 30 ditët e fundit) dhe e 9 në kategorinë e "të gjithë transmetuesve". Provajderi "live365.com" përfshinë mbi 2700 radio botërore.

BESUESHMËRIA DHE DËGJUESHMËRIA

Në muajin qershor 2003, Qendra për Studime Humanistike "Gani Bobi" shpalli rezultatet e një sondazhi të bërë me auditorin kosovar edhe lidhur me dëgjueshmërinë dhe besueshmërinë e radiove kosovare. Në bazë të këtij sondazhi, Radio Kosova është radioja më e besuar në Kosovë, ndërkaq që ajo prin edhe në dëgjueshmëri. Ndërkaq, Radio Blue Sky zë vendin e tretë ndër radiot më të dëgjua në Kosovë. Për oscilimet e dëgjueshmërisë së radiove kosovare, shih grafikunin nga hulumtimi "Gani Bobi".



SHËRBIMET E PËRBASHKËTA TË RTK-SË

ADMINISTRATA

RTK-ja është shërbim transmetues publik dhe udhëheqë një politikë transparente dhe racionale me resurse njerëzore duke kërkuar norma të cilësisë së lartë të kualifikimeve dhe shkathtësive profesionale për të punësuarit.

Procesi i kërkimit, përzgjedhjes dhe rekrutimit në RTK, në radhë të parë synon harmonizimin e potencialit njerëzor me nevojat programore, strategjike-zhvillimore dhe operacionale të organizatës, duke e mundësuar shfrytëzimin e plotë të këtij potenciali dhe zhvillimin e vazhdueshëm të tij.

Politika e RTK-së është gjithashtu që, me qëllim të menaxhimit racional me mjetet buxhetore, të punësojë kandidatë me kontratë mbi veprën, për ato vende të punës ku nuk është e domosdoshme prania e punëtorit në mënyrë permanente me orar të plotë të punës. Poashtu angazhimi i stafit kreativ programor bëhet edhe në bazë të projekteve konkrete programore. Vendet e punës në RTK do të plotësohen me kandidatët më të përshtatshëm, me kapacitet të dalluar.

Gjithashtu, RTK-ja i kushton rëndësi trajnimit permanent të të punësuarëve, në të gjitha nivelet, në harmoni me prioritetet e caktuara me plan të biznesit, për kandidatë që kanë afinitet për atë lëmi, dhe nevojë për trajnim. Organizimi i trajnimeve bëhet në mënyrë fleksibile me qëllim të korrespondimit me nevojat që dalin, duke pasur parasysh që RTK-ja ende është në fazë të zhvillimit.

Nga zyra e Shërbimit Administrativ në fillim të vitit është pregaditur dhe pastaj është aprovuar nga Bordi i RTK-së Rregullorja për Marrëdhënjet në Punë të RTK-së e cila është hartuar në harmoni me Ligjin Themelor të Punës në Kosovë në bazë të së cilës janë përcaktuar kategoritë e të punësuarëve me kontrata njëvjeçare mbi punësimin dhe kontrata mbi veprën.

Me këtë rregullore është përcaktuar orari i punës me kontrata mbi punësimin për të punësuarit e rregullt, mënyra e pagesës, format e pushimeve, siç janë pushimi vjetor, pushimi për raste të veçanta dhe pushimet mjekësore.

Një kaptinë e veçantë i është kushtuar edhe rregullave të sjelljes dhe masave disiplinore për të punësuarit.

Poashtu në fillim të vitit ka filluar të angazhohet mjeku i punës me orar të plotë të punës për të punësuarit e rregullt të RTK-së.

Kontratat mbi veprën për bashkëpunëtorët e jashtëm të RTK-së që kanë qenë me kohëzgjatje njëvjeçare, duke filluar prej fillimit të vitit 2003 janë bërë për një periudhë të caktuar kohore prej 1-3 mujore, me mundësi të ripëritjes.

Forma e vlerësimit gjashtëmujor të punës për të punësuarit në RTK është ndryshuar dhe është bërë dizajnimi i formës së re për vlerësime të të punësuarëve.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve të rregullt në RTK, në fund të vitit 2003 ishte 343 të punësuar prej të cilëve në RTK-Televizion ishin 237 ndërsa, në RTK-radio ishte 106 të punësuar. Ndërkaq në sektorin e administratës punojnë vetëm tre vetë, përfshi këtu Drejtorin e Administratës.

RTK-ja i kushton rëndësi të veçantë angazhimit të femrave në të gjitha segmentet brenda saj. Në vitin 2003 në RTK, gjithësej 94 ose 27.48 % femra kanë qenë të punësuar me kontrata të rregullta. Nga ky numër në Televizionin e Kosovës gjithësej 62 ose 26.27 % të punësuar femra ndërkaq, në Radio Kosovë dhe Radio Blue Sky gjithësej 32 ose 30.018 % femra të punësuar.

Mesatarja e moshës së të punësuarve në RTK, në Televizion dhe dy Radio Stacionet është 34.20. Në Televizion mesatarja është 32 vjet ndërsa në Dy Radio Stacionet është 38.4 vjet.

RTK-ja, gjatë procedurës së përzgjedhjes dhe varësisht nga kriteret dhe kushtet e kërkuara në bazë të politikave të RTK-së, ka punësuar dhe vazhdon të punësojë një numër të konsiderueshëm të ish punëtorëve të ish Radio Televizionit të Prishtinës apo fëmijë të tyre.

Gjatë viti 2003 janë përpiluar edhe një numër i konsiderueshëm i kontratave mbi bashkëpunimin programor të RTK-së me individ dhe kompani të ndryshme. Në këtë grup bën pjesë edhe kontrata mbi shërbimin, e lidhur me Koorporatën Energjetike të Kosovës (KEK), si një ndër kontratat më të rëndësishme për RTK.

PROKURIMI


Zyra e prokurimit në RTK filloi të funksionoj me 02 Janar 2003, pas rekomandimeve të marra nga ORPB (Organi Rregullativ i Prokurimit Publik) për themelimin e kësaj zyre në RTK .

Zyra e prokurimit në RTK udhëhiqet nga Menaxheri i Prokurimit. Kjo zyre ka funksionuar në bazë të Instruksionin Administrativ Financiar Nr.2/1999 e cila është në pajtim me paragrafin 1 të rregullores së UNMIK-ut 1999/16.

Gjatë këtij viti janë aplikuar të gjitha veprimet e prokurimit, prej fillimit të planifikimit të parë të prokurimit deri në përfundimin e realizimit të kontratave, gjithnjë duke i përdorur dokumentet standarde të përpiluara nga organi i lartëshënuar, gjegjësisht ORPB-ja.

FINANCAT

Të hyrat primare të RTK-se në vitin 2003 kanë qenë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës apo 28% i të hyrave të gjithëmbarshme; të hyrat nga parapagimi të cilat pritet të inkasohen në vitin 2004 e që përbëjnë afro 28% të të hyrave të gjithëmbarshme të RTK-së; të të hyrave nga marketingu që përbëjnë 17% të të hyrave të gjithëmbarshme; të të hyrave nga donatorët që përbëjnë 11% të të hyrave të gjithëmbarshme; të të hyrave nga spozorimet që përbëjnë 8% dhe të të hyrave të tjera që përbëjnë 8% e të të hyrave të gjithëmbarshme të RTK-së për vitin 2003.



Parapagimi për RTK-në ka filluar të implementohet nga 01.11.2003, përmes faturave të KEK-ut. Rezultatet e para mbi inkasimin e parapagimit, pritet të shifen në muajin Shkurt të vitit 2004 kur edhe duhet të bëhet pagesa e kistit të parë të mjeteve të inkasuara nga parapagimi.

RTK-ja beson se të hyrat primare, ndonse jo të vetme, do të duhej të jenë nga parapagimi si një nga mënyrat e zakonshme të financimit të transmetuesit publik. Grupi i ekspertëve ndërkombëtar (Task Force Group) në raportin e vet zyrtar thekson se RTK-ja duhet të aplikojë modelin e financimit të përzier, model ky i domosdoshëm, posaçërisht në vendet e vogla që nuk mund të përkrahin ekonomikisht një nivel të mjaftueshëm të shumës së parapagimit për transmetuesit publik.

Sidoqoft RTK-ja e konsideron se kur inkasimi nga parapagimi do të arrijë që RTK-së t'i sigurojë të hyra të sigurta dhe të mjaftueshme do të mundë të zbatoheshin disa kufizime për reklamimin e përgjithshëm në shërbimin terrestrial siç ndodh në shumë vende.

DONATORËT

RTK-ja është mirnjohëse për përkrahjen e rëndësishme të cilën gjatë vitit ia kanë dhënë Agjencioni Zvicëran për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) dhe Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER).


BILANCI I GJENDJES DHE I SUKSESIT PËR VITIN 2003

Plani i Biznesit për vitin 2003 është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të RTK-së në Janar të vitit 2003 dhe u është prezentuar donatorëve.

RTK-ja ndjek një politikë të kontrollit të kujdesshëm të shpenzimeve dhe synon të ofrojë shërbime që kanë vlerë më të madhe se mjetet e shpenzuara.

Në sektorin e Shërbimit financiar të RTK-së (dy Radiot dhe Televizion) janë të punësuar gjithsejt katër punëtorë, përfshir këtu edhe Drejtorin financiar.

Kontabiliteti udhëhiqet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në harmoni me Rregulloret përkatëse që janë në fuqi. Departamenti i financave i RTK-së pos raportit vjetor, përpilon edhe raportet financiare mujore dhe tremujore, të cilat rregullisht analizohen dhe shqyrtohen në Menaxhmentin e RTK-së dhe Bordin e Drejtorëve të RTK-së. Ekzistojnë politikat e shkruara financiare dhe procedurat strikte të kontrollit të shpenzimeve. Asnjë shpenzim nuk mund të lejohet dhe paguhet pa aprovimin paraprak me shkrim të së paku dy personave të autorizuar.




Pagesat e pagave të punëtorëve të rregullt, ata me kontrata mbi vepër si dhe honoraret, bëhen përmes llogarisë bankare ashtu sikurse edhe të gjitha llojet e tjera të shpenzimeve. Pagesat në para të gatshme bëhen vetëm në raste të veçanta dhe të domosdoshme. Pagesat e mëditjeve për udhëtime zyrtare Brenda dhe jashtë vendit bëhen në bazë të Rregullores së shkruar e cila është e specifikuar për secilin shtet veçmas.

Me Vendimin e Menaxhmentit të RTK-së është shpallur tenderi për përzgjedhjen e kompanisë ndërkombëtare e cila duhet të e bëjë auditimin e afarizmit financiar dhe të përgjithshëm të RTK-së për vitet 2002, 2003 dhe 2004 sipas standardeve ndërkombëtare.

Në përpjekje të arritjes së transparencës sa më të madhe financiare, gjatë vitit 2003 RTK-ja ka qenë e oditur nga Kompania ndërkombëtare për oditim Delloite & Touche, për vitin 2002. Raporti i oditimit është publikuar në veb-faqen e RTK-së. Gjithashtu kopjet e Raportit i janë dërguar Donatorëve si dhe të gjithë faktorëve relevant, vendorë dhe ndërkombëtar.

Bilanci i suksesit të RTK, sipas gjendjes 31 Dhjetor 2003

Nr.	SHPENZIMET	EURO	TË HYRAT	EURO
1	Shpenzimet e programit	2,184,486.55	Të hyrat nga BKK	2,000,000.00
2	Shpenzimet për personel	1,913,771.74	Të hyrat nga parapagimi	1,929,140.00
3	Amortizimi	1,352,504.78	Të hyrat nga donatorët	1,160,784.82
4	Shpenzimet tjera	965,406.25	Të hyrat nga marketingu	742,584.12
5	Tatimi & Kontributet	491,620.77	Sponsorimet	568,690.94
6			Të hyrat tjara	526,793.21
	Total Shpenzimet	6,907,790.09	Total të hyrat	6,927,993.09



Bilanci i gjendjes të RTK, me 31 Dhjetor 2003

Nr.	AKTIVI	EURO	PASIVI	EURO
1	Mjetet fikse	5,637,600.93	Kapitali	8,265,646.17
2	Kërkesat afatshkurtra	2,728,283.28	Obligimet afatshkurtra	424,550.77
3	Mjetet a gatshme	344,515.73	Mbetja	20,203.00
	Totali i aktivitet	8,710,399.94	Totali i pasivit	8,710,399.94

